



**INFORMACIONI PER NDERVEPRIMIN ME
MJEDISIN PER KARRIERE PER SHFRYTEZIMIN E
GELQEROREVE**

(Sipas Vendimit nr. 912 datë.11.11.2015)

Subjekti: “KUKES INERTE”SHPK

Përgatiti për “GBA STUDIO”: Eksperte Mjedisi Denisa KOLA

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Denisa Kola', is written to the right of the text 'Përgatiti për “GBA STUDIO”: Eksperte Mjedisi Denisa KOLA'.

SHTATOR 2017



PERSHKRIMI I PROJEKTTIT

- 1) Pershkrim i mbuleses bimore**
- 2) Informacion per pranine e burime ujore**
- 3) Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative**
- 4) Pershkrim i shkurter per shkarkimet e mundshme ne mjedis**
- 5) Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve**
- 6) Mundesia e rehabilitimit te mjedisit**
- 7) Masat e mundshme per shmangien e ndikimeve negative**
- 8) Ndikimet e mundshme ne mjedis**

Hyrje

Informacioni për nderveprimin me mjedisin të projektit hartohet në zbatim të vendimit Nr. **912 datë.11.11.2015**. Për miratimin e rregullave, të përgjegjesive e të afateve për zhvillimin e procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e Deklaratës Mjedisore.

1) Përshkrim i mbulesës bimore

Për nga origjina, perberja dhe vecoritë gjeobotanike bimesia e Shqipërisë bën pjesë në zonën floristike mesdhetare e cila përfshihet në një pjesë të madhe, në zonën holarktike. Ndikim të madh në zhvillimin e floras mesdhetare ushtroi ftohja e përgjithshme e klimes në periudhën e pleistocenit dhe akullzimi i fuqishëm që pasoi atë. Tiparet karakteristike të bimesisë mesdhetare si për sa i përket vecorive gjeobotanike ashtu edhe përberjes morfologjike dhe shtrirjes vertikale të saj, janë karakteristike edhe për bimesinë e vendit tona. Por kushtet konkrete të zhvillimit, sidomos të klimes dhe të relievit kanë përcaktuar edhe vecoritë origjinale të floras së Shqipërisë. E gjithë kjo pasuri floristike i detyrohet vecoritë të evolucionit paleogeografik të Shqipërisë dhe sidomos larmisë së madhe të klimes, copetimit të theksuar të relievit dhe formave të shumëllojshme të tij, formacioneve të shumta shkëmbore (karbonatike, magmatike, terrigjene) etj. Në rajonin ku bën pjesë projekti në fjalë për karrierën e shfrytëzimit të gelqeroreve zoteron bimesia e tipit mesdhetar. Ndryshueshmëria biologjike paraqitet e varfer, flora në zone është me zhvillim të dobët. Rrethi i Kukësit është mjaft i pasur në bimësi si në lloje ashtu edhe në shtrirje. Në qarkun e Kukësit takohen terriore me mikroklimë të ashpër malore, ku rriten dhe zhvillohen pyje fletorë dhe halorë. Si rrjedhojë, mbulesa bimore përbëhet nga dy grupe kryesore, që dallohen mirë nga njëra-tjetra. Bimësia me mbizotërim të elementeve floristik që zhvillohen në zonat me lartësi si (Koritniku, Gjalica, Kolesjani, Zepa, Alpet, Pashtriku etj.) dhe bimësia e tipit mesdhetar, e cila me ndërprerje depërton nëpërmjet luginave lumore të Drinit të bashkuar deri në qytetin e Kukësit. Bimësia është e përhapur në kate, por kufiri i tyre është i vështirë të dallohet. Për shkak të karakterit malor të terriorit bimësia shkallëzohet vertikalisht në breza të ndryshëm. E fillon me brezin e shkurreve, vazhdon me atë të dushkut, ahut dhe përfundon me kullotat alpine. Për arsye të ndikimit të klimës lokale dhe formave të ndryshme të relievit në të njëjtin kat vërehen përzierje bimësh.

Brezi i shkurreve përfshin një sipërfaqe prej 3160 ha. Në Kukës dhe disa zona të ulta të Tropojës gjenden shkurre si bushi, frashëri i bardhë, çermëdella, shkoza e zezë, lajthitë etj.

Brezi i dushkut shtrihet në lartësitë 800–1200 m mbi nivelin e detit ku bëjnë pjesë lloje të ndryshme panjash, frashëri i bardhë të cilat takohen në kurrizet e shpatet e kodrave, në rrëzën e maleve etj.

Brezi i ahut shtrihet në lartësinë 1500–1800 m mbi nivelin e detit kryesisht në shpatet lindore dhe veriore të maleve. Ata formojnë masive pyjore në malin e Gjalicës, Kallabakut, Kolesianit etj. Brenda pyjeve të ahut rriten edhe lloje të tjera drurësh gjethegjërë si shkoza e bardhë, panja e malit, panja si rrap, kurse nga drurët halorë takohet bredhi i bardhë, pisha e

zezë dhe arneni. Brezi i ahut nuk formon një brez të vetëm e të pandërprerë, por është i ndërprerë nga halorët në lartësinë 1600–800 m.

Brezi i kullotave alpine shtrihet mbi lartësinë 2000–2400 m. Ato zënë një sipërfaqe së bashku me livadhet prej 12410 ha. Kullotat shtrihen kryesisht në malin e Koritnikut, Gjalicës, Lumës, Shishtavecit, Kollovozit, Kolesianit dhe Pashtrikut.

Me posht paraqiten foto te bimesise qe rritet ne zone



Peme ah



Lajthi

Aktualisht nuk mund te flitet me per drurë apo dhe shkurre te larta natyrale ne zone . Ne teren konstatohen barishte, dhe bimësi me tipologji Ferre. Bimesia e kesaj zone përbehet kryesisht nga dushqet, nga shkurret mesdhetare kryesisht gjetherenese. Rajoni ka pozite dhe kushte shume te përshtatshme natyrore te përshatashme per zhvillimin e tij ekonomik : pasuri te shumta natyrore, relief te larmishëm, ne te cilin dallohen sidomos fushëgropat, gropat dhe luginat me toka te shumta për bujqësinë ; klime te përshtatshme për drithëra, lajthi, drithera, zarzavate, foragjere, etj. ; hidrografi te pasur ne lumenj dhe bimësi kryesisht shkurre.

Bota shtazore e qarkut të Kukësit me gjithë dëmtimet, ka përfaqësuesit e vet në të gjitha rrethet. Nga gjitarët grabitqarë (karnivore) që takohen në këto rrethe janë: ujku, dhelpra, rrëqebulli, macja e egër, kunadhja, zardafi, qelbësi, ariu, vjedulla etj. Nga gjitarët jograbitqarë janë: baldosa, derri i egër, lepuri, ketri, kaprolli, urithi, iriqi dhe më rrallë dhia e egër. Ndër shpendët grabitqarë janë: sorrat, laraskat, kukumjaçka, bufi, hutini, harabeli, gala, skifteri, fajkoi dhe shqiponja e malit. Midis shpendëve jograbitqarë janë: pëllumbi i egër, turtulli, gjeli i egër, shkurta, shapka dhe thëllëza e malit. Nga kafshët e ujit takohet: lundra (vidra) e cila jeton si në tokë ashtu edhe në ujë, rosa e egër, lloje të ndryshme peshqish, bajza, pulbardha dhe rrallë lejlekë.

Fitocenozat e bimesise barishtore shume te larmishme nga perberja e llojeve, gjenden ne te gjitha zonat fitokilmatike te Shqiperise, megjithese fitocenozat barishtore nga ana e fizionomise ne pergjithesi duken relativisht te peraferta, ato ndryshojne midis tyre nga perberja floristike ne varesi te faktoreve ekologjike. Me perjashtime te pakta, gati ne te gjitha

fitocenoza dhe bashkeshoqerimet barishtore gjenden perfaqesues te familjes graminore (Graminaceae). Neper shkembinj e sidomos ne te çarat e tyre , rritet nje bimesi e njohur me emrin hasmofite, e perbere nga draba thonjeze (draba aizoides L.), shmanga e baldacit (crepis baldaccii halacsy).



Rrodhja

Bimesia qe rritet ne rajon eshte bimesi qe i pershtatet kushteve te klimes se rajonit, brezit te pishave , me karakteristike qe rriten ne zone jane: Drure ose shkurre me lekure te lemuar te perhime. Sythat maje mprehte me melluga te shumta. Drure te rralle dhe shkurre. Druret me palce yndyrore peskendeshe. Sythet vezengjashem , gjethet te vrigulluara ose te dhembezuara, rrale te plota , renese ose te perhereblerta. Cdo lule rrethohet nga nje peshtjelle qe drunjezohet dhe shoqeron lendet. Pisha gjendet ne disa forma. Drure ose shkurre monoike. Gjethet te thjeshta , te kembyera, rnese. Lulet mashkull pa rrethlule nga nje ne sqetullen e cdo brakteje, me gathe cilindrike te varur ato femer me rrethlule te imet, me nga dy ne sqetullen e cdo brakteje, ne lulesa te clirta ose burbuqengjashme. Vezorja e neteshme, dykthinore. Fryti aken , me nje peshtjelle te formuar nga brakteja dhe braktezat rrites. Farat te ngreneshme. Persa i perket bimeve barishtore rritet rrodhja, caj , shpender, grem etj. Ne fshatrat perreth zones rriten edhe nje numer i konsiderueshem bimesh frutore si molle, ullinj, ftonj, dardha, kumbulla, etj. Persa i perket flores ne zonen ku do ushtrohet aktiviteti trajtim i

mbetjeve spitalore si shihet edhe nga fotot e meposhtme ajo paraqitet e zhveshur , vende – vende rriten shkurre te cilat nuk gezojne status te vecante ruajtje.

2) Informacion per pranine e burime ujore

Rethi i Kukësit ka potencial të konsiderueshëm të ujërave nëntokësore sidomos të burimeve karstike. Burimet dalin në rrëzë të maleve, brenda kanioneve apo në kontaktin e shkëmbinjve të përshkueshëm me ata të papërshkueshëm në lartësitë mbi 600–800 m deri në 1000 m. Burimet përbëjnë një pasuri të madhe në rrethin e Kukësit. Ata janë furnizuesit kryesorë të qendrave të banuara rurale me ujë të pijshëm. Qyteti i Kukësit që merr ujë për 24 orë e siguron atë nga burimet masive të Bjeshkëve të Kolosjanit.

Në këtë rajon takohen ujërat nëntokësor në depozitat zhavorr dhe në një thellësi 2.7 m deri në 5.5 m por në pusët e shpimit ai arrin të ngrihet dhe të stabilizohet në 0.6- 0.8 m thellësi dhe në varësi të stinës niveli i tyre ndryshon. Në këto ujëra është vërejtur dhe prania e gazrave të tretur si H₂S, NH₄, CH₄, etj. Në zonën ku do të ushtroi aktivitetin Firma “KUKES INERTE” sh.p.k vërehet se nuk ka burime sipërfaqësore. Në zonën e ushtrimit të aktivitetit dhe përreth saj nuk ka zona të lundrueshme dhe nuk ndodhen lumenj, liqene dhe dete, liqeni është larg zones ku do ushtrohet aktiviteti prandaj gjatë shfrytëzimit nuk do të cenohen rrugët ujore, brigjet lumenjtë, dhe bregdetet etj.

3) Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, toke, ajër

Ndikimet negative si gjelberimi i zones nga aktiviteti në fjalë nuk do të preken sepse vendi ku do të punohet dhe territori i këtij aktiviteti janë ekzistues përveç kësaj subjekti do të rrethojë aktivitetin dhe do të mbjelli përreth tij bimësi të zones dhe lule dekorative. Kurse për sa i përket zhurmave megjithatë ato janë të pa përfilleshme ato do të zgjasin për gjithë periudhën e ushtrimit të aktivitetit.

4) Përshkrim i shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis të tilla si: Ujra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurme, si dhe prodhimin e mbetjeve;

Sipërfaqja në të cilën do të ushtrohet aktiviteti nuk duket nga qendrat e mëdha të banuara , me përjashtim të rasteve të kalimtareve që udhetojnë në rrugën pranë. Aktiviteti nuk prek peizazhin ekzistues dhe topografinë e saj për gjatë kryerjes së aktivitetit . Me masat që do merren për rehabilitimin e saj, gjelberimin me bimë që rriten në zone, gjatë shfrytëzimit dhe në mbyllje të aktivitetit , peizazhi dhe topografia e zones do të përmiresohet dukshëm do të krijohet një ambient panoramik i këndshëm për syrin e njeriut dhe çlodhës. Dëmtimi i vegjetacionit bimor, është faktor negativ. Për nga pikpamja hidrologjike dhe hidrografike objekti i kërkuar ndodhet në kushte të mira. Nuk vihen re burime natyrore ujërash. Pikerisht në vendin ku kërkohet të ushtrohet aktiviteti për shfrytëzimin e gurit gelqeror nuk ka prroska. Kur ka reshje, nëpër të rrjedhin me rrembim ujra sipërfaqësore për shkak dhe të pjerresisë së terrenit. Për sa i përket zbatimit të këtij projekti nuk do të ketë ndikim në ndryshimin e

topografise se tokes . Persa i perket cilesise se ajrit ne zone ai konsiderohet me parametra te pranueshem duke qen se ndodhet larg zonave te banuara dhe nuk eshte i ndotur nga veprimtarite e industrise. Edhe zhvillimi i aktivitetit ne fjale nuk do te shkaktoj ndotje te ajrit sepse nuk do te kete emetime te gazeve ndotes. Per sa i perket shkarkimeve te gazeve ato do te jene mosperfillse se ne pune do te kete makina transporti dhe perdorimim te lendeve plasese. Pluhurat ne kete aktivitet do te jene fare te pakta pasi plura do te kete ne rruget e transportit brenda vendit ku ushtrohet aktiviteti por qe eshte menduar te sperkatet me uje sidomos ne periudhen e veres.

Zhurmat ne fazen e ndertimit nuk do te kete pasi nuk do te behen ndertime. Gjate fazes se pare paisjet e perdorura do te jene makinat qe do te transportojne materialin dhe makinerit qe do te perdoren per shfrytezim dhe transportin e gurit gelqeror.

Zhurma gjate fazes se shfrytezimit

Ndikim te zhurmave do te kete gjate procesve te punes se ushtrimit te aktivitetit. Niveli i zhurmave te ketyre makinerive , eshte i atij niveli qe nuk influencon si per te punesuarit, banoret dhe gjallesat per rreth tij. Niveli zhurmave nga puna e njekoheshme e makinerive ne distance 7 m nga to, eshte me i vogel se 70 dB. Duke mare parasysh shprehjen e nivelit te intensitetit akustik te nje zhurme me relacionin e me poshtem :

$$L = 10 \lg(I_1/I_0) \text{ ku}$$

L - Niveli akustik i zhurmes te marre ne konsiderate .

I_1 - Intensiteti akustik i zhurmave

I_0 - Intensiteti akustik i references

Vleresojme se niveli akustik i zhurmes ne rruge eshte me i ulet se ai i zhurmes se nje makine qe kalon ne te, praktikisht ai eshte 40-50 dB qe i pergjigjet kushteve te nje bisede me ze normal. Fenomene te tilla si vibracion, ndricim, nxehtesia jane te paperfillshme ne zhvillim te ketij aktiviteti ne kete objekt. Duhet theksuar qe vibracioni ne kete aktivitet nuk ndikon ne territor mbasi nuk ka objekte te te cilat ndihet influencia e minave. Siç thame edhe me siper, zhurmat qe do te krijohen gjate procesit te punes ne objekt jane vetem ato te shkaktuara nga makinerite e perpunimit , te ngarkimit e te transportit te cilat ato jane brenda normave.

5) Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve dhe

Mundesia e rehabilitimit te mjedisit

Rehabilitimi i plote i mjedisve te territorit do te jete si me poshte:

Mbjellja e taracave

Per regjenerimin e pejsazhit jane marre masa dhe eshte parashikuar projekt i veçante per te. Me fondet qe do te depozitoje subjekti per garanci rehabilitimi regjenerimi i pejsazhit do te rregullohet. Gjate punes, nuk do te kete ndotje te çfaredo lloji te zones. Mbas aktivitetit, nuk eshte planifikuar gje pasi zona ne fjale ka qene dhe do vazhdoje te jete e tille dhe nese nuk do

te perdoret nga e njejta kompani marrja e masave dhe shpenzimet perkatese per rigjenerimin e mjedisit dhe rregullimin e pejsazhit do te marren nga subjekti dhe do te behen rregullime per ta lene ate ne gjendjen e mepareshme..

Masat per rigjenerimin hap pas hapi, krahas aktivitetit konsistojne ne:

1. Krijimin e siperfaqeve per mbjellje;
2. Sistemimin e materialit;
3. Mbjelljen e siperfaqeve te reja me fidane drusore dhe barishte te ndryshme qe rriten ne zone;
4. Mirmbajtjen e siperfaqeve te mbjella;

Planifikimi i zones;

Per shmagen dhe parandalimin e erozinit, shembjes se siperfaqes dhe vithisjeve te ndryshme, ne projekt eshte percaktuar shfrytezimi harmonik dhe i kombinuar ne kohe dhe hapesire i zones ne terresi.

Gjate ushtrimit te aktivitetit, parashikohet trajtimi i te gjithë siperfaqes se shfrytezuar.

Kjo siperfaqe e perfituar nga trajtimet e mesiperme do te jape mundesi minimale per rikultivimin e bimeve dhe pemeve te ndryshme lokale, duke krijuar kushte per parandalimin e erozionit dhe permiresimit te pamjes se pergjitheshme te zones se shfrytezuar.

Plani i monitorimit te mjedisit

Per keto tip aktiviteti, eshte e domosdoshme qe nga shoqeria qe do te ushtroi aktivitetin ne bashkepunim me institucione te specializuara, te programohet monitorimi nga ndotja. Meqene se kemi te bejme me karire te shfrytezimit te gurit gelqeror nevojitet nje monitorim i vazhdueshem jo vetem ne siperfaqen e vendit ku do te ushtrohet aktiviteti por dhe ne nje zone mbi 300 m perrreth.

Plani i monitorimit do te konsistojne ne:

- Monitorimi i parametrave te tokes
- Monitorimi i zones se mundeshme te shperndarjes se pluhurit gjate
- Monitorimi i parametrave fizike dhe dinamike te shperndarjes se pluhurit dhe marrja e masave perkatese te parashikuara ne projekt, per parandalimin e tij
- Monitorimi i sjelljes se bimesise ekzistuese ne zonen per rreth aktivitetit dhe marrja e masave per parandalimin e demtimit te tyre.
- Monitorimi i siperfaqeve te mbushura me material dhe toke vegjetale per parandalimin e shplarjeve, gryerjeve, krijimin e gropave etj. Atje ku evidentohen demtime te kesaj zone do te merren masa per riparimin e tyre.
- Monitorimi i cilesise se ajrit dhe permbajtjes se pluhurave.
- Ndertimi dhe ruajtja e brezave te sigurimit.

- Sistemi i ujerave te bardha.
- Eliminimi i derdhjes se ujerave dhe karburanteve ne siperfaqen e tokes.
- Monitorimi i transportit te materialit gjate levizjes se automjeteve te cilat te jene te paisur me sistemet e sigurise.
- Emetimi i gazrave dhe zhurmave te makinerive ne ajer te kontrollohet nje here ne vit.
- Monitorimi i siperfaqeve te mbjella, pemeve dhe bimeve te kultivuara, ecurise normale e mbirjes dhe zhvillimit te tyre. Ne rastet kur verehet se ka demtime te merren masa per zevendesime me fidane te rinj. Monitorimi i çdo siperfaqe te mbjelle do te vazhdoje per nje periudhe 4 vjeçare, kohe gjate se ciles bimet kane mare nje zhvillim te konsiderueshem dhe nuk kane me nevojë per sherbime.

Shoqeria merr persiper sigurimin e ecurise normale te punes dhe ruajtjen e vazhdueshme te mjedisit deri ne mbylljen e aktivitetit. Shoqeria, gjithashtu, do te kete lidhje te vazhdueshme me Drejtorine Rajonale te Mjedisit dhe Agjensine Kombetare te Mjedisit Tirane, prane te ciles do te informoje periodikisht per mbarvajtjen e punes si gjate ushtrimit te aktivitetit ashtu dhe per monitorimin e parametrave te me siper.

6) Masat e mundshme per shmangien e ndikimeve negative

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne marrjen e masave per uljen e ndotjeve gjate ushtrimit te aktivitetit, ne ajer dhe toke, te pluhurave dhe zhurmave, si dhe uljen e efekteve negative hapsinore te territorit , faunen dhe floren. Por pikesynimi i studimit mbetet rehabilitimi i tokes dhe evitimi ne maksimum i ndotjes se mjedisit.

Dëmtimi i florës, faunës dhe bimët e ujit dhe masat parandaluese e rehabilituese;

Zona eshte pergjithesisht e zhveshur nga bimesia mbasi toka ku do te ushtrohet aktiviteti eshte toke private dhe nje pjese shume vogel e saj ka bimesi barishtore. Mbas aktivitetit, eshte parashikuar mbulimi i siperfaqes se punes me toke vegetale, per te krijuar mundesine e bimesise dhe pyllezimit. Ne zonen e aktivitetit nuk ka ndonje lloj ose specie flore apo faune qe mbrohet me sataus te veçante. Flora dhe fauna lokale nuk do te preket nga aktiviteti, pasi siperfaqja e vendit ku do te ushtrohet aktiviteti eshte pothuajse e zhveshur nga bimesia. Rrigjenerimi i vendit do te mundesoje mbjelljen e bimeve lokale.

Masat për rigjenerimin e peisazhit;

Per regjenerimin e pejsazhit jane marre masa dhe eshte parashikuar projekt i veçante per te. Subjekti ne fjale ka rrethuar vendin e ushtrimit te aktivitetit me mur. Gjate punes, nuk do te kete ndotje te çfaredo lloji te zones.

Masat per rigjenerimin hap pas hapi, krahas aktivitetit ne fjale konsistojne ne:

1. Mirembajtjen e siperfaqeve te mbjella;
2. Sistemimin e materialit te mbetjeve te naftes gjate transportit;

3.Mbjelljen e siperfaqeve te reja me fidane dhe barishte te ndryshme qe rriten ne zone;

7) Ndikimet e mundshme ne mjedis

Objekti eshte ne brendesi te territorit te vendit dhe nuk ka ndikime nderkufitare.

